



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM – ERZEN TIRANË

Nr. 1744/2 Prot.

Tiranë, më 28.6 . 2019

VENDIM
Nr. 9 Datë. 20.6 . 2019

PËR

MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR, "MIRATIM NË PARIM, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE" TË PELLGUT UJËMBLEDHËS TË LUMIT ERZEN, NË FSHATIN HEKAL, BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN "A.G.E ERZEN" SH.P.K

Në zbatim të ligjit nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar, përkatësisht neni 42 pika 3, neni 50 pika 2, neni 52 gërma c, të VKM-së nr.416, datë 13.05.2015, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes, për përdorim të burimeve ujore", të VKM-së nr.822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", neni 24 gërma f, i ndryshuar me VKM-në 718, datë 12.10.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave", "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni, të VKM-së nr.221, datë 26.04.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", të vendimit nr.6, të KKKU, datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", neni 11 pika 3 dhe vendimit nr.5, të KKKU, datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 7 pika 3 dhe neni 16, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen me propozim të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Ishëm- Erzen-Mat,

V E N D O S I :

1. Miratimin e "Autorizimit të përdorimit të burimit ujor, miratim në parim, për prodhim hidroenergjie" për ndërtimin e HEC "HEKALI", për subjektin "A.G.E ERZEN" sh.p.k, me të dhënat si më poshtë:

- Koordinatat e veprës së marrjes (sistemi koordinativ KRRGJSH)
 $X = 49\ 78\ 76,887$ $Y = 45\ 69\ 551,831$ $Z = 300\ m$
- Koordinatat e godines së centralit "HEC HEKALI" (sistemi koordinativ KRRGJSH)
 $X = 49\ 48\ 06,084$ $Y = 45\ 68\ 164,522$ $Z = 204\ m$
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (sistemi koordinativ KRRGJSH)
 $X = 49\ 48\ 06,084$ $Y = 45\ 68\ 164,522$ $Z = 204\ m$

- Prurja mesatare $Q_{mes.} = 4.7 m^3/s$
- Sasia e ujit që jepet për përdorim $Q_{llog.} = 3.0 m^3/s$
- Prurja ekologjike $Q_{ekol} = 0.4 m^3/s$
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer $Q_{shkarkimit} = 3.0 m^3/s$
- Trupi uJOR pritës Lumi Erzen

2. Në fazat e tjera, përpara miratimit të projektit të zbatimit, subjekti duhet të konsultojë projektin me Bashkinë e Tiranës, në lidhje me respektimin e skemës ujitëse të Skoranës dhe respektimin e nevojës për ujitje sipas prioriteve të ligjit 111/2012.

3. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Adrian Shtino



KRYETAR

Suzana Jahollari

